

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Hysni Ismaili, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.G., nga Ferizaj, për shkak të veprës penale mospërfillja e gjykatës nga neni 401 par. 1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së të akuzuarit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, P.nr.472/2016, të datës 20.10.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me 27.02.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar, ankesa e të akuzuarit A.G., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, P.nr.472/2016, të datës 20.10.2016, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Ferizaj, P.nr.472/2016, të datës 20.10.2016, është shpallur fajtor i akuzuari A.G., për shkak të veprës penale mospërfillja e gjykatës nga neni 401 par 1 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me gjobë, në shumën prej nga 200 (dyqind) €, të cilin dënim do ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditë, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20(njëzet) €.

Për realizimin e kërkesës pasurore juridike, e dëmtuara është udhëzuar në kontestin e rregullt civilo-juridik.

Është obliguar i akuzuarit që të paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 30 (tridhjetë) €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë i akuzuari, për shkak të vendimit për dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi me gjobë më i butë.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë me shkresën PPA/II.nr.162/2017, të datës. 07.02.2017, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e të akuzuarit, ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e të akuzuarit, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e të akuzuarit A.G., nuk është e bazuar.

Me qenë se aktgjykimi i shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, si dhe shkeljet e ligjit penal në dëm të akuzuarit, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ankimohet për shkak vendimit për dënimin, duke theksuar i akuzuari e ka mohuar kryerjen e veprës penale dhe ka theksuar se asnjëherë nuk e ka shkelur urdhrin mbrojtës me vetëdije, dhe as që e ka shqetësuar ndonjëherë të dëmtuarën, dhe ka kërkuar që ti shqiptohet dënim më i butë, ngase thekson se jeton në gjendje jo të mirë materiale, se është ushqyes i vetëm i familjes, se ka të ardhura mujore prej 85 (tetëdhjetë e pesë) €, andaj, me dënimin e shqiptuar gjendja ekonomike do ti vështirësohet edhe më shumë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesën e ushtruar nga i akuzuari, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim, se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se i akuzuari është i gjendjes së varfër ekonomike, është baba i dy fëmijëve, se është i papunësuar, se merr ndihmë sociale, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti, andaj, në prani të këtyre rrethanave, e duke mos gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, kolegji i kësaj gjykate, vlerëson se dënimi i shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, është proporcional me peshën e veprës penale të kryer, dhe është i bindur se me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS PA1. nr.139/2017 të datës 27.02.2017

**Bashkëpunëtori profesional
Hysni Ismaili**

**Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku**

**Kryetari i kolegjit
Ferit Osmani**

Biljana Rexhiq